

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Biljana Rexhiq, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kimete Veseli, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.R. nga Prishtina, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nën-paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.6152/2018 të datës 13 maj 2019, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.4737/2018, të datës 30 prill 2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 2 gusht 2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë e sipas detyrës zyrtare, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.4737/2018 të datës 30 prill 2019, përkitazi me kualifikimin juridik dhe dënimin e shqiptuar, ashtu që kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës veprimet e të pandehurit A.R. i kualifikon si vepër penale vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nën-paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK dhe për këtë vepër penale ndaj të pandehurit shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, të cilin dënim i pandehuri do ta mbajë pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e lartcekur, të pandehurin A.R. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 253 paragrafi 1 nën-paragrafi 1 të KPK dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 2 (dy) viteve i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale.

Është detyruar i pandehuri A.R. që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30 € (tridhjetë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të vendimit mbi dënimin, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës ta aprovoj ankesën si të bazuar, ndërsa ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, ashtu që të pandehurit t'i shqiptoj dënim me burgim.

Ndaj ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, përgjigje në ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurit, avokati A.B., duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ta refuzoj si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta vërtetoj.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/II.nr.786/2019, të datës 1 korrik 2019, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ndërsa të ndryshohet aktgjykimin i ankimuar, ashtu që ndaj të pandehurit të shqiptohet dënim me burgim.

Gjykata e Apelit e Kosovës e ka caktuar dhe mbajtur seancën e kolegjit konform nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) në të cilën seancë ka marrë pjesë i pandehuri A.R., së bashku me mbrojtësin e tij, avokatin A.B., ndërsa në këtë seancë nuk kanë marrë pjesë palët tjera, edhe përkundër faktit se është konstatuar se janë njoftuar në mënyrë të rregullt.

Mbrojtësi i të pandehurit, avokati A.B. gjatë seancës së kolegjit i ka propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimin i ankimuar të vërtetohet.

I pandehuri A.R. gjatë seancës së kolegjit ka deklaruar se e përkrahë deklarin e mbrojtësit të tij.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPP, konstatoj se :

- me aprovimin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë e sipas detyrës zyrtare duhet të ndryshohet aktgjykimin i ankimuar përkitazi me kualifikimin juridik dhe dënimin e shqiptuar.

Në ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë theksohet se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë nuk i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor. Dënimi i shqiptuar është

dënim i butë edhe përkundër faktit se gjykata e shkallës së parë ka marrë si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ka shprehur keqardhjen e tij lidhur me rastin, është penduar, ka pasur sjellje korrekte në gjykatë dhe se më parë nuk ka qenë i dënuar për veprë penale. Mirëpo, përveç tjerash në këtë çështje penale rrethanat lehtësuese në të cilat gjykata e shkallës së parë e ka mbështetur aktgjykimin i ka mbivlerësuar, çka do të thotë se dënimi nuk është në proporcion me peshën e veprës penale, sjelljen e të pandehurit, se i njëjti me rastin e kryerjes së veprës penale është pajisur me mjete adekuate me dorëza, shufër metalike dhe kaçavide dhe kanë depërtuar në dyqan, me ç'rast kanë marrë një sasi të arit prej 2,950 kg. Andaj, duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Prokuroria Themelore në Prishtinë i ka propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës si më lart.

Në përgjigjën në ankesë të mbrojtësit të të pandehurit, avokatit A.B. theksohet se gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar një dënim të drejtë dhe korrekt ndaj të pandehurit, kështu duke e arsyetuar në mënyrë të qartë dënimin e shqiptuar. Rrethanat për të cilat prokurori i shtetit kërkon dënim më të lartë janë elemente të veprës penale për çka edhe si e tillë është cilësuar në veprën penale vjedhje e rëndë e jo vjedhje. Gjithashtu, pretendimi i prokurorit të shtetit se me këtë dënim nuk do të zbehet motivi në asnjë rast që i pandehuri të vazhdoj të kryej vepra penale të natyrës së njëjtë, është i paqëndrueshëm, pasi që mbrojtja konsideron se dënimi me kusht është i mjaftueshëm sa për t'ia bërë me dije të pandehurit që në të ardhmen të mos përsërisë vepra tjera penale. Andaj, duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, mbrojtësi i të pandehurit i ka propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës si më lart.

Duke e shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës sipas detyrës zyrtare, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.4. lidhur me nenin 385 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.4. të KPP konstatoj se gjykata e shkallës së parë në rastin konkret ka shkelur ligjin penal në dëm të të pandehurit për shkak se lidhur me veprën penale të gjykuar është zbatuar ligji i cili nuk mund të zbatohet, përkatësisht nuk është zbatuar neni 23 i KPK që i referohet bashkëkryerjes. Nga shkresat e lëndës dhe nga aktakuza e ngritur rezulton se në rastin konkret i pandehuri A.R. ishte akuzuar për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1. lidhur me nenin 23 të KPK për të cilën veprë penale edhe e kishte pranuar fajësinë, ku më këtë rast gjykata e shkallës së parë kishte marrë aktvendim për pranimin e fajësisë duke konsideruar se janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë. Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura dhe duke ju referuar edhe faktit se i pandehuri edhe vet e ka pranuar fajësinë, se veprën penale në fjalë e kishte kryer në bashkëkryerje me të pandehurin tjetër R.N., atëherë kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës konstaton se veprimet e të pandehurit A.R. duhet të kualifikohen si veprë penale vjedhje e rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nën-paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK.

Sa i përket dënimit të shqiptuar, sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet e lartcekura të paraqitura në ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë janë të bazuara, për faktin se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është i butë. Gjykata e shkallës së parë më rastin e shqiptimit të dënimit me kusht i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese, ndërsa në anën tjetër nuk i ka marrë për bazë rrethanat rënduese të rastit konkret të cilat kanë ekzistuar me rastin e shqiptimit të dënimit. Me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht, gjykata e shkallës së parë si rrethana lehtësuese për të pandehurin A.R. kishte marrë për bazë faktin se i njëjti ishte i sinqertë gjatë shqyrtimit fillestar, se e ka pranuar fajësinë dhe se nuk ka qenë i dënuar më parë, ndërsa nuk ka gjetur rrethana rënduese për të njëjtin. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës konstaton se në rastin konkret ekzistojnë rrethana rënduese të cilat është dashur që gjykata e shkallës së parë t'i ketë në konsideratë më rastin e shqiptimit të dënimit, në veçanti kur kemi parasysh faktin se nga shkresat e lëndës rezulton se i pandehuri A.R. veprën penale për të cilën është shpallur fajtor e kishte kryer në bashkëkryerje me të pandehurin Riad Nishevci; kohën e kryerjes së veprës penale (01:30 minuta pas mesnatës); mënyrën e kryerjes së veprës penale, duke u pajisur me dorëza, shufër metalike dhe kaçavidë, duke u ngjitur nga shkallët e dyqanit dhe duke prerë rrjetën e hekurit, të pandehurit kishin hyrë në katin e sipërm të dyqanit të stolive “Dhakan Jewelry Shop”; se veprën penale e kishin kryer pas një marrëveshje paraprake dhe se në rastin konkret bëhet fjalë për një sasi të stolive të arit në peshë rreth 2.950 kg, etj. Të gjitha këto rrethana është dashur që të vlerësohen si rrethana rënduese me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit A.R. dhe se në raport me rrethanat e lartcekura lehtësuese, rrethanat rënduese do të duhej të mbizotërojnë, kështu që nuk arsyetohet në asnjë variant shqiptimi i dënimit me kusht në rastin konkret. Duke i marrë për bazë të gjitha këto që u cekën më lart, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës konstaton se gjykata e shkallës së parë ndaj të pandehurit A.R. ka shqiptuar një dënim tejet të butë, andaj edhe është vendosur që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë me ç'rast ndaj të pandehurit është shqiptuar dënim me burgim efektiv, siç është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Për këto arsye që u theksuan më lart, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës ka ardhur në përfundim se ndaj të pandehurit A.R., duhet të shqiptohet dënim më i ashpër, siç është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se një dënim i tillë është dënim i drejtë, i ligjshëm, në harmoni me peshën e veprës penale dhe pasojat e saj, në harmoni me mënyrën e kryerjes së veprës penale, në harmoni me cilësitë personale të të pandehurit, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës është i bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 34 të KPK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Duke u bazuar në këto që u thanë më lart e në bazë të nenit 398 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.4. të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.770/2019, më datën 2 gusht 2019

Bashkëpunëtorja profesionale,
Kimete Veseli

Anëtarët e kolegjit:
Afrim Shala

Kryetar i kolegjit,
Gani Zabeli

Biljana Rexhiq
